



REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIE E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE AGENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY			
Njësia Org. Org. e dritës Org. Unit	A.Q.P.	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	067/15
Nr. / Fajzave Br. Stranica No. Pages	113	Data: Datum: Date:	21.05.2015
Faqe 8 / a			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance  
Agjencia Qendrore e Prokurimit  
Centralna Agencia Nabavke  
Central Procurement Agency

DATE/A:	21.05.2015
PËR/ZA/TO:	Autoritetet Kontraktuese
NGA/OD/FROM:	Mursel Racaj, Drejtor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informim lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit: Faza II; Furnizim me mazut; Furnizim me pelet, dru dhe thëngjill; Furnizim me goma.

Të nderuar,

Ju informojmë se Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 16.02.2015 ka publikuar Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 për aktivitetet e prokurimit të centralizuar në ueb-faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe ueb-faqen e Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP). AQP është përcaktuar që të fillojë me tri procedura të centralizuara për të cilat edhe ka publikuar njoftimet paraprahe:

- 1 Furnizim me Mazut
- 2 Furnizim me pelet, dru dhe thëngjill
- 3 Furnizim me Goma

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka dorëzuar formularin për grumbullimin e të dhënave tek autoritetet kontraktuese të cilat janë në listën e prokurimeve qendrore, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015. Në momentin e njoftimit, ne kemi pranuar edhe disa kërkesa nga autoritetet kontraktuese që nuk janë në listën për prokurime të centralizuara e që dëshirojnë të jenë pjesë e prokurimeve të centralizuara. Të gjitha autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të jenë pjesë e prokurimeve të centralizuara duhet drejtuar AQP-së me një shkresë, deri me datën 29-05-2015 në ora 14:00

AQP do të zhvilloj vetëm nga një herë aktivitetet e prokurimit (nënshkruaj kontratë) për tri vitet e ardhshme, prandaj cilido autoritet kontraktues që dëshiron të jetë pjesë e prokurimeve të centralizuara duhet drejtuar me shkresë AQP-së deri me datën e lartcekur.

Çdo kërkesë për furnizim/shërbim që dorëzohen nga Autoritetet Kontraktuese pas këtij afati nuk do të pranohet nga AQP-ja

Në kërkesë duhet që të specifikohen sasi të përafërta dhe vlera e përafërt për 36 muaj.

Shembull i plotësimit të kërkesës.

Logo e institucionit

E protokolluar nga kërkuesi – institucioni

Data	
Për	Zt. Mursel Racaj
Përmes:	
Cc:	
Nga :	
Titulli:	Furnizim me Mazut për periudhën 36 muaj Furnizim me pelet, dru dhe thëngjill për periudhën 36 muaj Furnizim me Goma për periudhën 36 muaj

I nderuar z. Racaj

Në bazë të nenit 95, pika 4 e Ligjit të Prokurimit Publik, nr. 04/L-042, përmes kësaj shkrese, kërkojmë që për nevoja të (shëno emrin e Autoritetit Kontraktues) të zhvilloni procedurat e prokurimit për furnizim me mazut, furnizim me pelet, dru dhe thëngjill, Furnizim me Goma për periudhën kohore prej 36 muaj. Kontratës ekzistuese afati i skadon me datën (shëno datën kur i skadon afati kontratës ekzistuese që keni në fuqi).

Formulari për grumbullimin e sasive të përafërta vjetore dhe vlera e parashikuar mund të shkarkohen në ueb-faqe e AQP-së: <http://aqp.rks-gov.net/> ose mund të kërkohet në adresat elektronike:

Libona.thaqi@rks-gov.net: Furnizim pelet, dru dhe thëngjill

Selma.haxhani@rks-gov.net: Furnizim me Goma

Libona.thaqi@rks-gov.net: Furnizim me Mazut

Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve duke shënuar vlerën e parashikuar për 36 muaj.

Edhe për aktivitetet e tjera të prokurimeve të centralizuara të cilat priten të zhvillohen nga AQP-ja në vitin 2015, mund të na drejtoheni në të njëjtën formë pas publikimeve të njoftimeve paraprake dhe njoftimeve në ueb-faqen e AQP-së.